



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:186997  
Datë: 21.11.2024  
Numri i dokumentit: 06489621

**Kom.Dh.Shk.II.nr.1825/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Kolegji UBT me seli ne Prishtinë, e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arta Tahiri, kundër të paditurës-kundërpropozuesit, Komuna e Lipjanit, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit/paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Adminsitrativ, KA.nr.322/24 të datës 22.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.11.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e propozuesit – paditesit Kolegji UBT me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal KA.nr.322/24 të datës 22.08.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti Fiskal, në pikën I të dispozitivit është HEDHET poshtë propozimi i paditësit "Kolegji UBT" sh.p.k, kundër te paditurës Komuna e Lipjanit, për shtyrje te njoftimit publik për dhënie ne shfrytëzim afatgjatë te pronës se paluajtshme, si i paplotësuar.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, Kolegji UBT me seli ne Prishtinë, e të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arta Tahiri,, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dyte aktvendimin e kontestuar ta ndryshon dhe të aprovojë kërkesën në tërësi .\

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së kunderpropozuesit-te paditurës, kolegji i kësaj gjykate, gjen se Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje te njoftimit publik për dhënie ne shfrytëzim afatgjatë te pronës se paluajtshme të paditurës Komuna e Lipjanit, gjykata ka konstatuar se propozimi duhet plotësuar, andaj me aktvendim e datës 22.07.2024 gjykata ia ka kthyer ne plotësim propozimi për masë qe te plotësohet me: dëshmia e dorëzimit te padisë, dëshmia e pagesës se taksës për padi, dëshmia e pagesës se taksës për mase, te gjitha ne afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit te aktvendimi.

Pala paditëse – propozuese aktvendimin e datës 22.07.2024 e ka pranuar me date 25.07.2024, mirëpo nuk ka vepruar sipas vërejtjeve te gjykatës, dhe nuk e ka kthyer te plotësuar propozimin për mase, andaj gjykata e shkalles se pare konform, nenit 253.1 par.2 dhe 3 i LPK-se nëse padia nuk plotësohet sipas vërejtjeve ne këtë aktvendim do te hedhet poshtë te e paplotësuar.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm një konkludim të tillë të gjykatës së shkallës së parë ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara në nenin 22 par. 2, 3, e cila dispozite përcakton se “Bashkë me kërkesën për shtyrje duhet paraqitur prova, që tregon se padia është parashtruar”.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale dhe nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e caktimit te masës se përkohshme dhe shtyrjes se ekzekutimit te vendimit dhe se pretendimet ankimore janë të pa ndikim për vendosje në mënyrë tjetër, andaj ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**Kom.Dh.Shk.II.nr.1825/2024, me datë 21.11.2024**

**Kryetari i kolegjit-Gjyqtari**  
**Faton Bajrami, d.v**